Njeriu më fatlum që do ta fitojë ndërmjetësimin (shefatin) tim Ditën e Gjykimit është ai që deklaron: "La ilahe il lallah (s'ka të adhuruar të denjë përveç Allahut)" me zemër të sinqertë, - ose ka thënë: me sinqeritet.”

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: I Dërguari i Allahut është pyetur "Kush është njeriu më fatlum që do ta fitojë ndërmjetësimin (shefatin) tënd Ditën e Gjykimit?" I Dërguari i Allahut i tha: “Kam pandehur, o Ebu Hurejre, se askush para teje nuk do të më pyesë për këtë çështje, për shkak se kam vënë re se ke interesim të madh për hadithin. Njeriu më fatlum që do ta fitojë ndërmjetësimin (shefatin) tim Ditën e Gjykimit është ai që deklaron: "La ilahe il lallah (s'ka të adhuruar të denjë përveç Allahut)" me zemër të sinqertë, - ose ka thënë: me sinqeritet.”

[Sahih] [Transmeton Buhariu]

Profeti në këtë hadith na tregon se njeriu më fatlum që do ta fitojë ndërmjetësimin (shefatin) e tij në Ditën e Gjykimit është ai që deklaron: "La ilahe il-lallah (s'ka të adhuruar të denjë përveç Allahut)" me zemër të sinqertë dhe është i pastër nga shirku (idhujtaria) e rijaja (syefaqësia).

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/3414